

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT –i:

Adresa e Selise:

Data e krijimit:

Nr. I Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

“VIANTE Konstruksion” sh.p.k

K47103804L

Gramsh

23.02.2005

33037

Ndertim – Projektim, Rikonstruksione

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2017

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2017-31.12.2017

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 28.02.2018

Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivitet monetare	4	450,881	963,518
Investime		-	-
Të drejta të arkëtueshme		-	-
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		115,057,449	75,321,100
<i>Tvsh kreditore</i>		12,057,432	10,370,129
<i>Tatim fitimi I mbipaguar</i>		271,706	430,920
<i>Te tjera</i>		-	-
Totali I te drejtave te arketueshme	5	127,386,587	86,122,149
Inventarët		-	-
<i>Lende e pare dhe materiale</i>		6,007,033	7,362,366
<i>Parapagime per inventar</i>		-	-
Totali I inventarit	6	6,007,033	7,362,366
Shpenzime të shtyra		-	2,762,926
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
Totali I aktiveve afatshkurtra		133,844,502	97,210,959
Aktive financiare		-	-
Aktivitet materiale		-	-
<i>Ndertesa</i>		-	-
<i>Makineri e pajisje</i>		3,006,164	3,435,714
<i>Mjete transporti</i>		17,721,781	17,266,190
<i>Pajisje zyresh</i>		-	-
<i>Te tjera pajisje dhe informatike</i>		1,029,905	531,732
Totali I aktiveve materiale	7	21,757,850	21,233,635
Aktivitet biologjike		-	-
Aktive jo materiale:		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	-
Total Aktive		155,602,352	118,444,594

Administratori

Gjergji Bezat
Gjergji Bezat
 PROJEKTIM - ZERAVIM
 VIANTE Konstruktion
 sh.p.k.
 IMPORT - EKSPORT

Hartuesi i pasqyrave
Anita PULAJ
 NUIS K31512115F
 Licenca Nr.155
 TRANA - ALBANIA
Anita Pulaj

Pasqyra e Pozicionit financiar

<u>PASIV</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime afatshkurtra:		-	-
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		84,653,991	49,374,512
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		10,290,930	12,950,653
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		486,534	584,834
<i>Te pagueshme te tjera</i>		500,000	5,790,000
<i>Te pagueshme (divident I paterhequr)</i>		25,200,000	25,200,000
Shuma detyrime afatshkurtra	8	121,131,455	93,899,999
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		121,131,455	93,899,999
Detyrime afatgjata:		-	-
<i>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</i>		-	-
<i>Të ardhura të shtyra</i>		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Total detyrime afatgjata		-	-
Total detyrime		121,131,455	93,899,999
Kapitali dhe Rezervat		-	-
<i>Kapitali i Nënshkruar</i>		1,100,000	1,100,000
<i>Rezerva te tjera</i>		23,444,595	14,908,382
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>		9,926,301	8,536,213
Total kapitali aksionar	9	34,470,896	24,544,595
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		155,602,352	118,444,594

Administratori


 Gjergji Bezati



 Hartuesi i pasqyrave
 Anita Pulaj

<u>Pasqyra e performances</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	10	309,560,923	148,956,936
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	11	931,000	-
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	12	(78,572,137)	(72,738,712)
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(51,600,487)	(58,590,123)
<i>Të tjera shpenzime</i>		(26,971,651)	(14,148,589)
Shpenzime të personelit	13	(28,558,182)	(25,977,135)
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(24,471,467)	(22,259,743)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(4,086,715)	(3,717,392)
Zhvierësimi i aktiveve afatgjata materiale	14	(607,953)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	15	(4,224,960)	(2,140,368)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	16	(187,046,718)	(42,799,461)
Të ardhura të tjera	17	390,250	4,351,477
Zhvierësimi i aktiveve dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare	18	(82,379)	416,858
<i>Shpenzime per interesa</i>		-	-
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		-	(16,418)
<i>Fitime/humbje nga kurset e kembimit</i>		(56,564)	524,621
<i>Te ardhura te tjera</i>		-	-
<i>Gjoha dhe interesa</i>		(25,815)	(91,345)
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi/Humbja para tatimit	19	11,789,843	10,069,595
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(1,863,542)	(1,533,382)
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>	19	(1,863,542)	(1,533,382)
Fitimi/Humbja e vitit	19	9,926,301	8,536,213
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		9,926,301	8,536,213

Administratori


Gjergji Bezati
 PROJEKTI MËSHTO
 VIANTE Konstruksion
 sh.p.k
 IMPORT - EKSPORT



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	Shenime	(metoda indirekte)	
		31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		11,789,843	-
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		4,224,960	-
<i>Shpenzime të shtyra</i>		2,762,926	(2,762,926)
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		-	-
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		1,271,234	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		-	-
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		(41,264,438)	5,806,675
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		1,355,333	(7,362,366)
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		27,088,798	7,736,865
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		-	-
<i>Tatim fitimi I paguar</i>		(1,720,884)	(1,117,716)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		5,507,772	2,300,532
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		-	-
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(6,020,409)	(13,724,621)
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		-	-
<i>Dividentë të arkëtuara</i>		-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(6,020,409)	(13,724,621)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		-	-
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit		-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare		(512,637)	785,874
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		963,518	177,644
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor		450,881	963,518

Administratori

Gjergji Bezati

 Gjergji Bezati
 PRUEKTIM - ZBATIM
 VIANTE Konstruktion
 sh.p.k
 IMPORT - EKSPORT


 Eksperte kontabel e Autentifikues
 I.E.K.A
 Hartuesi i pasqyrave
Anita PULAJ
 NUIS K31512115F
 Licence Nr.155
 TIRANA - ALBANIA
 Anita Pulaj

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	1,100,000	4,671,147	10,237,235	16,008,382
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël				
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			8,536,213	8,536,213
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:		10,237,235	(10,237,235)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	1,100,000	14,908,382	8,536,213	24,544,595
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Fitimi / Humbja e vitit			9,926,301	9,926,301
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:		8,536,213	(8,536,213)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	1,100,000	23,444,595	9,926,301	34,470,896

Administratori

Gjergji Bezati
 Gjergji Bezati
 PROJEKTIM ZBETIM
 VIANTE Konstruksion
 sh.p.k.
 IMPORT - EXPORT



Hartuesi pasqyrave

Anita Pulaj

SHENIMET SHPJEGUESE**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria « VIANTE Konstruksion» shpk është krijuar në datë 23.02.2005 me Vendimin Nr. 33037 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ortak dhe administrator të vetëm Z. Gjergji Bezati. Kapitali i shoqërisë është 1,100,000 leke dhe kuotat e tij zotërohen 100% nga ortaku I vetëm.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të

shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa

mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera

financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%



iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe

detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatuueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci Kontabel, Aktivet

4. Aktivet monetare

Aktivët monetarë janë në shumën 450,881 leke, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Likuiditete	Viti 2017	Viti 2016
1	Depozita në banke	432,767	961,867
2	Para në arke	18,114	1,651
	Totali	450,881	963,518

Depozitat në banke në monedhe të huaja janë të konvertuara me kursin e datës 31.12.2017, diferencat nga kursi i kembimit janë të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



5. Te drejta te arketueshme

Paraqitet shuma e te drejtave te arketueshme deri me 31.12.2017, prej 127,386,587 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Klient per shitje e sherbime	115,057,449	75,321,100
2	Tatim fitimi I mbipaguar	271,706	430,920
3	Tvsh	12,057,432	10,370,129
	Totali	<u>127,386,587</u>	<u>86,122,149</u>

6. Inventarët

Ne kete post paraqitet me 31.12.2017 inventari i materialeve ne shumen 6,007,033 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Materiale ndertimi	6,007,033	7,362,366
	Totali	<u>6,007,033</u>	<u>7,362,366</u>

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2017 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

7. Aktive materiale

Aktivitet afat gjata materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 21,757,850 leke, sipas tabelës se meposhtme :

Nr	Emertimi	Mjete Transporti	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
I	Aktive afat gjata materiale				
1	Gjendja me 31.12.2016	23,775,317	5,229,137	1,411,588	30,416,041
2	Shtesat per 2017	5,375,947	-	644,462	6,020,409
3	Paksimet per 2017	(2,202,549)	-	-	(2,202,549)
4	Gjendja me 31.12.2017	<u>26,948,715</u>	<u>5,229,137</u>	<u>2,056,050</u>	<u>34,233,901</u>
II	Amortizimi I AQT-ve				
1	Gjendja me 31.12.2016	6,509,127	1,793,424	879,856	9,182,406
2	Shtesat per 2017	3,649,122	429,550	146,289	4,224,960
3	Paksimet per 2017	(931,315)	-	-	-
4	Gjendja me 31.12.2017	<u>9,226,933</u>	<u>2,222,973</u>	<u>1,026,145</u>	<u>12,476,052</u>
III	Vlera neto 31.12.2017	<u>17,721,781</u>	<u>3,006,164</u>	<u>1,029,905</u>	<u>21,757,850</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016.



Bilanci Kontabel, Pasivet

8. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2017 paraqiten ne shumen 121,131,455 leke, si me poshte :

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2017	Viti 2016
1	Detyrime per Furnitore	84,653,991	49,374,512
2	Detyrime per paga	10,290,930	12,950,653
3	Detyrime tatimore	486,534	584,834
4	Hua te marra nga shoqeria	500,000	5,790,000
5	Divident I paterhequr	25,200,000	25,200,000
Totali I detyrimeve		<u>121,131,455</u>	<u>93,899,999</u>

8.1 Detyrime per Furnitore

Paraqitet gjendja e palikujduar e furnitoreve me 31.12.2017 ne shumen 84,653,991 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2017 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

8.2 Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqitet detyrimi ndaj punonjesve per paga i palikujduar deri me 31.12.2017 ne shumen 10,290,930 leke.

8.3 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Jane te paraqitura detyrimene shumen 486,534 leke, me 31.12.2017 sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2017	Viti 2016
1	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	478,828	577,584
2	Tatimi mbi te ardhurat personale	6,500	6,500
3	Tatim ne burim	1,206	750
Totali I detyrimeve		<u>486,534</u>	<u>584,834</u>

8.4 Te pagueshme te tjera

Paraqitet detyrimi i shoqerise per hua te marre nepermjet bankes ne shumen 500,000 leke ne 31.12.2017.


8.5 Te pagueshme ndaj ortakeve (Divident I paterhequr)

Paraqitet shuma e detyrimit per divident te shperndare nga shoqeria po te palikujduar deri me 31.12.2017 ne vleren 25,200,000 leke. **Theksojme se shoqeria e ka paguar detyrimin per tatimin mbi dividentin sipas afateve ligjore.**

9. Kapitali

Kapitali paraqitet si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2016	1,100,000	14,908,382	8,536,213	24,544,595
2	Shtesat per 2017	-	8,536,213	9,926,301	18,462,514
3	Pakesimet per 2017	-	-	(8,536,213)	(8,536,213)
Gjendja me 31.12.2017		<u>1,100,000</u>	<u>23,444,595</u>	<u>9,926,301</u>	<u>34,470,896</u>



Gjate vitit 2017 kapitalet e veta jane shtuar me fitimin e vitit ne shumen 9,926,301 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise eshte 34,470,896 leke.

PASH-Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

10. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqerise per vitin 2017 jane 309,560,923 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura nga aktiviteti	309,560,923	148,956,936
	Totali I te ardhurave	<u>309,560,923</u>	<u>148,956,936</u>

Sqarim per raportimin e shitjeve ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%”:

Ju sqarojme se shuma e te ardhurave prej 68,151,224 leke, e raportuar ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%” perfaqeson vleren e sherbimeve qe shoqeria ka kryer per punimet ne Hydrocentralin e Banjes, per shoqerine “Limak” shoqeri nenkontraktore e “Devoll Hydropower”, e cila ka te drejte te emeroje nenkontraktore te nivelit te 2-te (Viante Konstruksion), nga ku lind e drejta per te pergatitur fatura te cilat do te jene me TVSH 0% dhe do te pasqyrohen ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%” me shenimin perkates “Sipas regjimit specifik te TVSH-se sipas ligjit Nr. 105/2013 date 28.03.2013”.

11. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Te ardhurat e realizuara nga shitja e aktiveve te shoqerise per vitin 2017 jane 931,000 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura nga shitja e aktiveve	931,000	-
	Totali I te ardhurave	<u>931,000</u>	<u>-</u>

12. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2017 eshte 78,572,137 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Materiale te para	50,245,154	65,952,489
2	Ndryshimi I gjendjes	1,355,333	(7,362,366)
	Shuma I	<u>51,600,487</u>	<u>58,590,123</u>
	<i>Te tjera shpenzime</i>		
1	Karburant	26,791,066	13,592,119
2	Materilae ndihmese	75,068	474,725
3	Kancelari	105,517	81,745
	Shuma II	<u>26,971,651</u>	<u>14,148,589</u>
	Shuma I+II	<u>78,572,137</u>	<u>72,738,712</u>

13. Shpenzime te personelit

Shpenzimet per personelin ne shumen 28,558,182 leke jane te detajuara si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime per paga	24,471,467	22,259,743
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	4,086,715	3,717,392
	Shuma	<u>28,558,182</u>	<u>25,977,135</u>

14. Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale

Jane llogaritur shpenzimet per vleren e automjetit te njerre jashte perdorimit ne shumen 607,953 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Zhvleresimi I aktiveve	607,953	-
	Shuma	<u>607,953</u>	<u>-</u>

15. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e aseteteve sipas normave ligjore ne fuqi per 4,224,960 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Amortizimi I aktiveve	4,224,960	2,140,368
	Shuma	<u>4,224,960</u>	<u>2,140,368</u>

16. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Ne kete ze jane ne shumen 187,046,718 leke, te perfshira si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime telefonike	169,696	183,934
2	Sherbim kontabiliteti, auditimi, noterie	1,650,723	513,700
3	Sigurime mjetesh, taksa	485,228	344,002
4	Testim Betoni	-	2,000
5	Certifikim personeli	90,000	80,000
6	Sigurim kontrate	-	100,000
7	Komision ekzekutimi permbarimor	-	45,187
8	Transport per blerje	20,834	41,668
9	Qera	60,000	60,000
10	Punime nga nenkontraktore	178,480,305	32,069,382
11	Veshje pune dhe Materilae ndihmese	530,410	2,499,655
12	Certifikim ISO	-	172,500
13	Sherbime bankare	32,016	45,599
14	Taksa Lokale	-	116,834
15	Dieta per personelin	-	6,525,000
16	Studim gjeologjik - hidrologjik	120,000	-
17	Riparime mjetesh	1,972,400	-
18	Vlera kontabel e Aqt-ve te shitura	663,281	-
19	Te tjera	8,900	-
20	Rimarrje shpenzimesh nga 2016	2,762,926	-
	Shuma	<u>187,046,718</u>	<u>42,799,461</u>



Kuadrimi I blerjeve me shpenzimet e paraqitura ne bilanc

Ne tabelen e meposhtme paraqitet kuadrimi i blerjeve te pasqyruara ne FDP mujore me shpenzimet e perفشira ne pasqyrat financiare per vitin 2017.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje te perjashtuara	10,659,122
2	Blerje investimi brenda vendit pa tvsh	1,373,430
3	Blerje nga furnitore vendas	250,146,182
4	Blerje investimi brenda vendit 20%	631,031
5	Importe investimi I perjashtuar	4,053,057
6	Korigjohet me referencen e doganes se investimit	(37,113)
	Totali I blerjeve	<u>266,825,709</u>
Nr	Sipas bilancit	
1	Blerje materialesh	50,245,154
2	<i>korigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	1,355,333
3	Të tjera shpenzime	26,971,651
3	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	187,046,718
4	Blerje AQT	6,020,409
	Shuma	<u>271,639,265</u>
Nr	Diferenca	<u>4,813,556</u>
1	<i>Sherbime bankare</i>	(32,016)
2	<i>Vlera kontabel e Aqt-ve te shitura</i>	(663,281)
3	<i>Rimarrje shpenzimesh nga viti 2016</i>	(2,762,926)
	Shuma	<u>(3,458,223)</u>
	Diference FDP-Bilanc	<u><u>0</u></u>

17. Te ardhura te tjera

Paraqiten te ardhura ne shumen 390,250 leke, te perfituara nga si shperblim demi, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura te tjera	390,250	4,351,477
	Totali I te ardhurave	<u>390,250</u>	<u>4,351,477</u>

18. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime per vitin 2017 ne shumen 82,379 leke te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Fitime nga kursi I kembimit	(56,591)	524,621
2	Te ardhura nga interesa bankare	27	(16,418)
3	shpenzime per gjoba e penalitete	(25,815)	(91,345)
	Totali I te ardhurave	<u>(82,379)</u>	<u>416,858</u>

19. Llogaritja e rezultatit tatimor

Shoqëria per vitin ushtrimor 2017 paraqitet me nje fitim neto prej 9,926,301 leke.

Nr	EMERTIMI	VITI 2017	VITI 2016
1	Te ardhura nga aktiviteti	310,491,923	148,956,936
2	Te ardhura nga shperblim demi	-	4,351,477
3	Totali I te ardhurave	310,491,923	153,308,413
2	Shpenzime	(298,702,080)	(143,238,818)
3	Rezultati I ushtrimit	11,789,843	10,069,595
4	Shpenzime te pazbritshme	633,768	152,950
	a- Gjoha e penalitete	25,815	91,345
	b- Vlera e asetit te nxjerre jashtepedorimit	607,953	-
	c- shpenzime pa fature	-	61,605
5	Fitimi I tatueshem	12,423,611	10,222,545
6	Tatimi I fitimit	1,863,542	1,533,382
7	Fitimi neto I periudhes	9,926,301	8,536,213

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 633,768 leke, jane shpenzime per gjoha e penalitete si edhe vlera e asetit te nxjerre jashtepedorimit.

20. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Gjergji Beza
 Gjergji Beza



 Hartuesi i pasqyrave
Anita PULAJ
 NUIS K31512115F
 Licenc - Nr.155
 TIRANA - ALBANIA
 Anita Pulaj